



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA-SHTIME/OPŠTINA-ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Zyra e Kryetarit të Komunës
Kancelarija Predsednika Opštine/Mayor's Office



02 Nr. 812

Datë: 05.12.2022

Në bazë të neneve 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, në bazë të nenit 38, paragrafët 5 dhe 6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe në bazë të nenit 46 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Kryetari i Komunës së Shtimes merr:

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT TË VLERËSIMIT PËR LËVIZJEN BRENDA KATEGORISË
(Për pozitën Zyrtar për shërbime publike – Drejtorja për Shërbime Publike)

I. Formohet Komisioni i vlerësimit për lëvizjen brenda kategorisë të komunës së Shtimes në këtë përbërje:

1. Naim Hasani (Zyrtar në Personel) – Kryesues i komisionit
2. Gojart Bajrami (Zyrtar për efikasitet të energjisë) – anëtar
3. Skender Dauti (Përgjegjës i zyrës për mbrojtje dhe shpëtim) - anëtar
4. Kimete Ukaj (Udhëheqës i sektorit për financa) - anëtar
5. Miftar Miftari (Përgjegjës për Teknologji Informativ) – anëtar

II. Anëtarët zëvendësues të komisionit:

1. Besnik Shala (Zyrtar i Personelit I)
2. Albulenë Emini (Inspektor për Mjedis dhe Ambient)
3. Rahman Selmani (Inspektor i komunikacionit dhe shërbimeve publike)
4. Bujar Ferati (Zyrtar Kryesor Financiar)
5. Lulzim Muharremi (Përgjegjës i përfaqësimit ligjor)

IV. Komisioni duhet të veprojë në bazë të dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

V. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Iu dërgohet:

Anëtarëve të komisionit

Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore

Arkivës

